

REKOMANDIME KOMISIONIT PARLAMENTAR MBI REFORMEN ZGJEDHORE

Tiranë, 09.03.2018

Në dallim nga praktikat e mëparshme, Kuvendi miratoi menjëherë pas nisjes së legjislaturës së re, krijimin e Komisionit të Posaçëm parlamentar për Reformën Zgjedhore. Kjo është shenjë pozitive, por që të përkthehet në zhvillim pozitiv do të kërkojë që Komisioni të veprojë në afate të arsyeshme kohore për të jetuar ndryshimet e nevojshme në legjislacionin zgjedhor.

Jetësimi i 23 rekomandimeve të dhëna në raportin final të Misionit të ODHR/OSBE është dhe mbetet detyrim prioritar për Shqipërinë. Çdo dokument zyrtar për Shqipërinë, përfshirë deklaratat e SHBA dhe të BE, vënë theksin tek vlerësimi i rekomandimeve, duke i dhënë fund praktikës negative të komisionit të kaluar parlamentar për reformën zgjedhore. Disa prej rekomandimeve të Misionit nuk reflektojnë çështjet reale të defekteve të sistemit përfaqësues në Shqipëri, gjithsesi, ato mbeten pika referimi.

ISP vlerëson se është me **rëndësi jetike** që rekomandimet e ODIHR/OSBE janë e duhet të jenë prioritare. Çdo përpjekje **për mbivendosje** në prioritet, sidomos në çështjet e votimit të emigrantëve dhe të përdorimit të teknologjisë në votim, e dëmton procesin, e vonon atë dhe e lë peng të konfliktualitetit politik ose shanseve për një vendimmarrje të sforcuar mbi bazën e konsensusit politik të minutës së fundit. Votimi i emigrantëve dhe teknologjia në votim janë të rëndësishme, por janë pjesë e axhendës politike, ndërkohë që rekomandimet e misionit vëzhgues të zgjedhjeve janë pjesë e axhendës shtetërore.

-
- Praktikë e **përdorimit të teknologjisë në zgjedhje**, sipas mendimit tonë, duhet të aplikohen edhe në Shqipëri, duke filluar me zgjedhjet e ardhshme lokale me zona pilot, të zgjedhura nga palët përbërëse të komisionit. Nëse në zonat pilot projekti funksionon, le të kalohet në një fazë tjetër kombëtare. Nevoja e pilotimit është substanciale për të shmangur konfliktin politik dhe për të krijuar një bazë besimi të qëndrueshëm lidhur me reformën dhe zgjedhjet
- Praktikë e **votimit të emigrantëve**, sipas mendimit tonë, duhet të paraprihet nga hartimi i regjistrit të votuesve jashtë Shqipërisë, një punë që kërkon shumë kohë dhe investime. Nëse kjo ndodh deri në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, atëherë hapet rruga reale drejt një formule përfaqësimi përmes pjesëmarrjes direkt në votim ose përmes kuotave të rezervuara.
- **Depolitizimi i administrimit** zgjedhor duhet të marrë trajtim sa më parë për ta larguar Shqipërinë nga harta e vogël e vendeve me administrim tërësisht partiak. Një hap në këtë drejtim mund të jetë aplikimi në zgjedhjet lokale 2019 të administrimit zgjedhor të pjesshëm (në disa bashki) nga studentët e fakulteteve juridike dhe ekonomike në Shqipëri. Zgjedhja rastësore e tyre dhe njohja e këtij kontributi si kontribut profesional do të krijojë klimë më të

madhe besimi sesa militantët partiakë, përgjegjës për të gjitha devijimet zgjedhore në 27 vite në Shqipëri.

- Palët politike do të duhet që publikisht **të përjashtojnë** nga radhët e tyre të gjithë komisionerët e deritanishëm, të provuar ose denoncuar nga KQZ në zgjedhjet e fundit lokale e parlamentare. Ky do të ishte një sinjal i vullnetit të mirë politik.

Komisioni i Reformës Zgjedhor ka detyrimin që në faqen zyrtare të Kuvendit të publikojë në mënyrë të detajuar aktet e vendimmarrjes brenda tij, axhendat dhe vendimet, seancat dëgjimore dhe të gjitha materialet që i adresohen komisionit, në mënyrë që puna e tij të jetë **sa më transparente dhe të fitojë besim publik**.

Referuar matricës së planit të punës të Komisionit të Reformës Zgjedhore, ekziston një bazë e fortë besimi se këtë herë ndërhyrjet e mundshme në legjislacion do të duhet të jenë efektive, pozitive dhe në kohë. Megjithatë, referuar problematikave reale dhe defekteve në sistemin përfaqësues, ISP vlerëson se asnjë ndërhyrje teknike në legjislacionin zgjedhor nuk zgjidh problematikat e plota të zgjedhjeve, nëse fokusi nuk do të jetë edhe **ndërhyrja e thellë, konsensuale, transparente dhe sa më profesionale në legjislacionin mbi partitë politike**.

Partitë politike në Shqipëri gëzojnë pushtet më të lartë sesa u njih Kushtetuta, ato janë burim i karrierës politike, ato udhëheqin procesin zgjedhor dhe kanë monopolin e vendimmarrjes politike, përfshirë edhe në përbërjen dhe drejtimin e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore. Për të gjitha këto arsye, ecja paralel, me ndryshime në legjislacionin mbi partitë politike dhe në Kodin Zgjedhor dhe aktet e tjera të lidhura me to, do të ishin zgjidhja më e mirë, më e qëndrueshme dhe më efektive.

REKOMANDIME NE LIGJIN MBI PARTITË POLITIKE DHE KODI ZGJEDHOR

Ekzistenca e partive politike, roli dhe funksionimi i tyre, transparenca financiare dhe përgjegjësia publike, hapësira për konkurrim, ofertat elektorale dhe alternativat programore janë e mbeten vlera të demokracisë dhe kushte të panegociueshme. Nëse partitë nuk janë dhe nuk sillen të tilla, e gjithë piramida e zgjedhjeve komprometohet dhe vetë zgjedhjet nuk ofrojnë zgjidhje.

Për më tepër, Kushtetuta e Shqipërisë neni 9 përcakton vijat orientuese për rolin dhe aktivitetin e partive politike, ndërkohë që ndërhyrjet në Kushtetutë në kuadër të reformës në drejtësi i referohen direkt partive kur përcaktojnë si kriter konkurrimi për poste në gjyqësor, prokurori, etj, kushtin që individit *“nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit”*. A mund të realizohet një kusht i tillë në rrethanat kur në Shqipëri nuk ka asnjë institucion ku strukturat e partive politike regjistrohen dhe monitorohen?

Ligji aktual i partive politike në disa elementë vjen në kundërshtim me parimet kushtetuese (neni 9), është jo funksional dhe përdoret shpesh si alibi për mbi-pushtetin dhe statusin e paprekshmërisë së partive politike.

- Aktualisht partitë politike nuk kanë asnjë akt të depozituar të zgjedhjeve të tyre të rregullta në **strukturat drejtuese** në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe as në institucione të tjera. Kjo do të thotë, ekzistojnë pamundësi reale për verifikimin e të dhënave mbi strukturat drejtuese në partitë politike (129 parti politike legale) në 10 vitet e fundit. Për jetësimin e këtij kriteri kushtetues duhet bërë ndryshim në ligjin “Për partitë politike” për të detyruar partitë të depozitojnë çdo vit në Gjykatë ose KQZ, strukturën dhe emrat përbërës të saj në nivel kombëtar dhe lokal.



- Ligji ka specifika lidhur me krijimin e partive politike, por nuk parashikon një trupe ligjore ose mekanizëm të **verifikimit të aktivitetit dhe ekzistencës së partive politike**. Në listën e partive politike ligjore të regjistruara në Gjykatën Tiranë figurojnë aktive të paktën katër parti politike me emrat e kryetarëve të tyre, kur këta të fundit kanë vite që kanë ndërruar jetë. Ligji mbi partitë, neni 7, përcakton rastet e ndalimit të një partie politike gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit në gjykatë (në gazën e gjykimit mbi miratimin e saj), por legjislacioni nuk ka asnjë mekanizëm efektiv që monitoron partitë politike në aktivitetin ditor të tyre nëse vepron në përputhje me ligjin, nëse kryejnë akte që përbëjnë arsye për ndalim. Legjislacioni ynë nuk ka asnjë përcaktim vlerësues **për partitë informale**, dhe ndaj i konsideron ato partive politike efektive dhe ligjore, për shkak se ekzistojnë formalisht në gjykatë aktet e themelimit të tyre. Kjo ka çuar në rritje formale të numrit të partive politike dhe lehtësi të trafikimit të tyre. KQZ në aktet e tij i referohet regjistrimit në gjykatë, pa marrë parasysh nëse regjistri është i saktë dhe funksional. Gjykata nuk bën verifikime të aktivitetit të partive, thjesht miratimin e tyre. Ekzistenca e një numri të madh të partive fiktive ka krijuar tregun e partive, sidomos në funksion të koalicioneve të mëdha, duke dëmtuar ndjeshëm cilësinë e zgjedhjeve, besimin publik dhe produktin e sistemit fiktiv partiak në qeverisjen e vendit.
- Partitë duhet të ofrojnë publikisht listën e kryetarëve lokalë dhe të strukturës drejtuese, madje edhe adresat e tyre të kontaktit, si dhe vendimet që lidhen me zgjedhjet periodike në parti, sipas statuseve të tyre funksionalë. Ndaj në ligjin **“Për partitë politike”, neni 6-8** të përcaktohet detyrimi që partitë politike të depozitojnë çdo vit strukturat e tyre të zgjedhura pranë gjykatës Tiranë, të detyrohen të jenë subjekte aktive dhe konkurruese elektorale, si dhe nëse ato marrin më pak se 3000 vota (minimumi për krijimin e një partie politike) automatikisht të konsiderohen të shpërndara.
- Për evitimin e këtij defekti ligjor, në ligjin **“Për partitë politike”,** të përcaktohet detyrimi i shtetit për të bërë transparencën e pronave të partive politike. Detyrimi ligjor që ngarkon Ministrinë e Punëve të Brendshme për inventarizimin e pronave të partive nuk është përmbushur, dhe se partitë vijnë të jenë subjekte juridike në shumicën e tyre me mjedise, zyra dhe mjete pune të peregjistruara në shtet dhe të përfituara në mënyrë preferenciale politike. Zgjedhja mund të jetë duke krijuar një mekanizëm kontrolli pranë KQZ (Kosova ka një model funksional në këtë pikë), si dhe duke krijuar strukturë funksionale për partitë në proporcion me votat e tyre parlamentare. Në trajtim të përfshihen edhe kandidatët e pavarur apo subjektet kolektive elektorale.
- Ligji mbi partitë politike, neni 5, thekson se *“veprimtaria e partive politike mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në disa njësi të ndarjes administrative territoriale të vendit”,* pra nuk ligjërohet shtrirja jashtë territorit të RSH, sic kanë bërë partitë kryesore politike prej disa vitesh. Madje ligji ndalon krijimin e partive politike jashtë RSH. Shtrirja jashtë territorit të RSH kërkon ndryshime në ligj, dhe mundësi praktike të transparencës dhe aktivitetit të degëve në emigracion, për përputhje të tyre me kërkesat ligjore në Shqipëri. Ose koncepti i territorit duhet respektuar, ose organizimi jashtë duhet përfshirë në ligj dhe detyrimin që strukturat jashtë dhe burimet e tyre të financimit të jenë gjithashtu në përputhje me nenin 9 të Kushtetutës së RSH.
- Për të përmbushur parimet kushtetuese referuar partive (neni 9, pika 1 dhe 2 e Kushtetutës), dhe për të ndihmuar që partitë të jenë demokratike në organizim, sugjerojmë që në regjistrimin e partive politike dhe kandidatëve të tyre në KQZ të shtohet si kërkesë, **dokumentimi zyrtar i vendimmarrjes në parti për secilin kandidat** (nëse është zgjedhur nga strukturat partiake, cila është pozita e tij, si është zgjedhur dhe nëse organi që e propozon ka legjitimitet sipas kriterëve të ligjit mbi partitë politike). Çdo parti që regjistrohet duhet detyruar të sjellë në KQZ aktin e vendimmarrjes (Kongresi, Kuvendi, etj) të marrë në



përputhje me statutin e tyre dhe ligjit mbi partitë dhe të depozituar në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

- **Legjislacioni zgjedhor ka nevojë të ndryshojë në disa elementë që lidhen me kandidimin në zgjedhje, financimin dhe rolin e shtetit në fushatë. Konkretisht,**
 - Legjislacioni ynë është **penalizues ndaj prurjeve të reja politike**: parti ose kandidatë. Ne duhet të aplikojmë standardet e vendeve të BE kur pengesat ligjore (numri i firmave, dokumentacionit shoqëruar, etj) të jenë shumë më liberale, sidomos në zgjedhjet lokale. Një kandidat i pavarur dhe një listë mbështetëse e tij në Tiranë kërkon më shumë firma nënshkruese paraprake sesa numri i votave me të cilat de facto zgjidhet kryetari i bashkisë Tiranë. E drejta e deputetëve/kryetarëve të bashkive për të kandiduar automatikisht si të pavarur ose me një subjekt të ri, pamundësohet nga ligji, duke krijuar pengesa shtesë dhe duke mos lejuar me ligj zgjerimin e konkurrencës politike. Heqja e kufizimeve ekstreme (ulja e numrit të firmave mbështetëse dhe lehtësimi i procedurave) ofrojnë më shumë alternativa për qytetarët, dhe për pasojë, më shumë demokraci përfaqësuese.
 - Misioni i ODIHR sugjeron për një mekanizëm **monitorimi të rolit të administratës** në zgjedhje dhe të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatë. Ne mendojmë se kjo praktikë duhet të përfshijë jo vetëm periudhën zgjedhore, por të gjithë periudhën 9 mujore nga momenti kur Presidenti i Republikës ka shpallur dekretin për datën e zgjedhjeve. Dekreti për zgjedhjet duhet të jetë pikë referuese për të gjitha masat parandaluese, në të gjitha çështjet përkatëse të Kodit Zgjedhor. Kodi duhet të detyrojë **ekzekutivin dhe institucionet publike të bëjnë publike** menjëherë pas daljes së dekretit të Presidentit për zgjedhjet, të gjithë buxhetin dhe parashikimet e investimeve, strukturën organike të punësimit, etj, në mënyrë që të parandalohet qartësisht abuzimi me fondet, investimet, punësimet sezonale, etj, për efekte elektorale.
 - Legjislacioni ynë ka qenë shpesh i paqartë për **rastin e konfliktit të interesit**, - zyrtarët që konkurrojnë në zgjedhje dhe që mbajnë poste publike, si dhe ata që kanë status të pavarur ose të nëpunësit civil deri ditën e regjistrimit në KQZ si kandidatë. Ne sugjerojmë të bëhen ndërhyrje në Kod për të rritur numrin e funksionarëve që duhet të japin dorëheqje nga posti për shkak të përfshirjes në fushatë direkt (si kandidatë) ose indirekt (si anëtarë në stafet elektorale). Në këtë kategori duhen të përfshihen, psh, të gjithë drejtuesit e enteve publike dhe të gjithë ata që kanë kompetencë të përfaqësojnë institucionin e tyre në raport me të tretët.
 - **Financimi elektor** dhe formula e ndarjes së fondeve mbetet shumë spekulative. P.sh, ne kemi aktualisht një grup parlamentar të ndërtuar në mënyrë informale, që përfiton nga financimi, ndërkohë që deputetët ose kryetarët e bashkive/këshilltarët që vendosin të dalin më vehte në zgjedhje nuk përfitojnë financim megjithëse kanë legjitimitet më të madh sesa grupet fiktive parlamentare. Financimi duhet të jetë unik dhe të ecë sipas praktikës perëndimore, **1 votë – 1 euro**, e konvertuar sipas sasisë së buxhetit të shtetit në dispozicion, në mënyrë që të parandalojë trafikimin e votave dhe abuzimin me financimin, siç ndodh edhe aktualisht. Financimi duhet të shkojë edhe tek kandidatët e pavarur (rasti kroat, me mbi 5% të votave lokale) ose subjektet e vogla (mbi 3000 mijë vota), sipas numrit të votave që kanë marrë në zgjedhje, edhe nëse një kandidat ose subjekt ka marrë qoftë edhe 1 votë më shumë.



- Koncepti i **përfaqësimit gjinor** përmes kuotës së kandidimit (zgjedhje lokale e parlamentare) ka çuar në lista formale nga partitë e vogla politike ose penalizime nga KQZ për partitë e mëdha. Sugjerojmë që në Kod penalizmi të mos jetë me shifër financiare, por me kërcënimin se subjekti nuk do të regjistrohet në zgjedhjet pasuese të radhës, pra një masë shumë më e fortë dhe më efektive.
- Lidhur me transparencën financiare: modeli kroat parasheh deklarim të të gjitha burimeve dhe kontroll mbi donatorët çdo 6 muaj, kurse Kushtetuta jonë parasheh vetëm deklarim “kurdoherë” ndërsa Kodi e ka rritur periudhën e deklarimit në 1 vit. Transparenca duhet të përfshijë edhe pagesat për rrjetet sociale (që nuk parashikohen aktualisht në ligj) si dhe detyrimin që partitë çdo vit të deklarojnë numrin e anëtarëve dhe kuotën financiare të tyre.
- Lista e sponsorizimeve dhe e shpenzimeve të partive politike nuk mund të jetë vetëm objekt shqyrtimi mbi KQZ (zgjedhur nga vetë partitë) ose ekspertët financiarë (të zgjedhur nga KQZ, pra indirekt nga partitë), por të jetë në cdo kohë disponibel edhe për publikun e gjerë, OJF dhe median, cilido subjekt që është i interesuar.
- Partitë politike duhet të kjenë objekt i ligjit mbi të drejtën e informimit për të gjithë ato çështje që përcaktohen në Kushtetutë dhe në Ligjin mbi partitë politike. Çështja e financimit dhe demokracisë funksionale brenda partive nuk është çështje “e brendshme”, por çështje ligjore dhe me interes publik.

LIDHUR ME LIGJIN MBI DEKRIMINALIZIMIN DHE AKTET NENLIGJORE RRETH TIJ:

- Në parlamentin e ri ka më pak individë me rekorde kriminale, por për shkak të procesit të papërfunduar dhe interpretimeve në legjislacion, do të vijojmë të **kemi individë me rekorde negative** që nuk kanë penalizuar direkt nga ligji i de-kriminalizimit. Gjithashtu kemi e do të kemi edhe më tej individë që janë nën akuzë për vepra të ndryshme penale, përfshirë pastrim parash, korrupsion, abuzim me detyrën dhe postin, etj.
- Një numër individësh me rekorde kriminale janë larguar nga listat e kandidimit, por ata janë dhe mbeten **aktiv në drejtimin e stafeve elektorale** dhe të fushatës elektorale në zonat e tyre të influencës. Kjo do të thotë, partitë i larguan ata nga parlamenti apo bashkitë për të evituar sulmet publike, por i mbrojtën dhe i angazhuan ata në fushatë për të siguruar maksimalizim të votave të tyre, kryesisht përmes influencës në grupet kriminale, përmes frikësimit, presionit dhe format joligjore të sigurimit të votës.
- Në asnjë nga rastet e mësipërme partitë politike respektive, nuk kanë deklaruar distancimin zyrtar nga individë, përkundrazi. Ato vijojnë tu ofrojnë atyre mbështetje maksimale publike, gjë që bie në kundërshtim me deklaratimet e tyre për vullnet politik në jetësimin e procesit të dekriminalizimit. Edhe partitë e tjera politike parlamentare, zyrtarë të cilave janë arrestuar ose dënuar brenda kornizës së neneve penalizuese të de-kriminalizimit. Ndërhyrja në ligj për të detyruar partitë e subjektet elektorale të distancohen publikisht ose të penalizohen nga KQZ nëse nuk distancohen, nga individët me rekorde kriminale në stafet elektorale, është mëse emergjente.
- Ligji i dekriminalizimit **nuk ka arritur të krijojë mekanizma funksionarë afatgjatë verifikimi** dhe se prokuroria dhe KQZ kanë dështuar të aplikojnë standarde të njëjta për vepra të njëjta penale dhe për raste të njëjta në parti të ndryshme politike.



- Vonesa në organizimin zgjedhor dhe kriza politike parazgjedhore **pamundësoi verifikimin e kandidatëve për deputetë**, duke paralajmëruar se edhe pas hapjes së parlamentit të ri do të kemi raste të tjera me akuza dhe me siguri, edhe raste të tjera të deputetëve që do të humbasin mandatin parlamentar për shkak të rekordeve negative në të kaluarën e tyre.
- Dy strukturat ligjore të ngarkuara për zbatimin e këtij ligji, **KQZ dhe Prokuroria**, kanë përmbushur formalisht detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, por hartimi dhe miratimi i ligjit pa marrë në konsideratë aftësinë dhe kapacitetet e këtyre organeve për zbatim integral të ligjit, ka krijuar situata penguese.
- Partitë kryesore politike kanë njoftuar transferimin e parimeve të de-kriminalizimit edhe në dokumentet e tyre statusore dhe ngritjen e strukturave përkatëse verifikuese. Deri tani, asnjë parti nuk ka depozituar ndryshime të tilla në Gjykatën e faktit Tiranë (ku respektohen ndryshimet në legjislacion, si dhe asnjë strukturë partiake verifikuese nuk është mbledhur dhe as ka vepruar).
- Në ligjin **“Për partitë politike”, neni 11**, në statutet e tyre të përfshijnë konceptin e de-kriminalizimit, si dhe në zgjedhjet për organet drejtuese në degë edhe në qendër, të aplikojnë testimin e kandidatëve të tyre me përcaktimet / kategorizimet e ligjit të de-kriminalizimit.
- Në ligjin **“Për partitë politike”, neni 11**, të përcaktohet detyrimi që partitë politike, në statutet e tyre të përfshijnë konceptin e de-kriminalizimit, si dhe në zgjedhjet për organet drejtuese në degë edhe në qendër, të aplikojnë testimin e kandidatëve të tyre me përcaktimet / kategorizimet e ligjit të de-kriminalizimit.
- Në **Kodin Zgjedhor (neni 67 dhe 68)** të përcaktohet se nëse partitë zgjedhin në struktura drejtuese individë me të shkuar kriminale, ato duhen trajtuar në të njëjtën formë si me rastin e kandidatëve zyrtarë në zgjedhje, me dallimin se në rastin e partive, ato duhen penalizuar me gjoba të larta financiare deri në humbjen e të drejtës për regjistrim në zgjedhje.
- Në ligjin **“Për partitë politike” (neni 21)dhe Kodin Zgjedhor (neni 89)**, duhet përcaktuar detyrimi (+ sanksioni përkatës) që partitë të mos pranojnë sponsorizim financiar nga individë me të shkuar kriminale, pra që emrat e individëve me të kaluar kriminale ose me aktivitet kriminal ekonomik, të përjashtohen nga e drejta e financimit / kontributit elektorale tek partitë dhe kandidatët në zgjedhje.
- Në ligjin **“Për partitë politike” (neni 21)dhe Kodin Zgjedhor (neni 89, 84, 85)**, të përcaktohen nene penalizuese e përjashtuese për individët me rekorde kriminale (objekt i de-kriminalizimit) për të marrë me qira ose blerë media vizive, audio ose të shkruara, me objekt përdorimin në fushatat elektorale.
- Përfshirja në **Kodin Zgjedhor (neni 61)** e dispozitës të nenit 12 të ligjit të de-kriminalizimit që lidhet me veprimet në lidhje me zgjedhësit.
 - a. *Specifikimi më tej ne ligj i rasteve kur zgjedhësi është dënuar jashtë vendit*
 - b. *nëse ky dënim vlen edhe për Shqipërinë (rasti i ekstradimeve, i marrëveshjeve midis dy vendeve për transferim, etj),*
 - c. *rastet e pamundësisë së verifikimit (pjesa më e madhe e rasteve të dënimeve penale të shtetasve shqiptarë në botë nuk janë të njohura për shtetin shqiptar).*
- Përfshirja në **Kodin Zgjedhor (neni 63.3)** të neneve specifike ligjit të de-kriminalizimit, që lidhen me kushtet për kandidim dhe për t’u zgjedhur në funksione publike.



- Në **Kodin Zgjedhor (neni 63 deri 69)** duhet të bëhet ndryshimi ligjor për përputhjen e afateve për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendin dhe Organet e Qeverisjes Vendore me afatet për verifikimin e integritetit.
- Në **Kodin Zgjedhor**, të shtohet një nen, me objekt, krijimin e një strukture speciale në KQZ, me burime njerëzore, financimi dhe përgjegjësi për ndjekjen e të gjitha praktikave ligjore të deklarimeve/verifikimeve që burojnë nga ligji i de-kriminalizimit. Pamundësia aktuale teknike dhe e burimeve njerëzore për të kryer këtë proces brenda afatit ligjor dhe me cilësinë e duhur, duhet të jetë objekt debati në Komisionin e Reformës, dhe të ofrohet zgjidhje e qëndrueshme për të ardhmen.
- **Kodi Zgjedhor (nenet 67-68)** duhet të trajtojë rastet e kandidimit në zgjedhje të pjeshme, periudha e kufizuar kohore nuk lejoi kohë për KQZ dhe organet e tjera të ligjit, për të kryer verifikimin teknik të kandidatëve. Në rastin e një kontestimi politik, ky element teknik mund të shndërrohet në burim krime politike.
- **Kodi Zgjedhor** duhet të trajtojë rastet e zëvendësimit të mandateve të deputetëve në parlament, të ministrave në qeveri dhe të këshilltarëve në këshillat bashkiakë: debati mbi natyrën e verifikimit, afatet e verifikimit, rastet e mungesës së përgjigjes nga institucionet etj.
- **Ligji 138/2015 dhe Vendimi i Kuvendit 17/2016** duhet të sqarojë, nëse vetë-deklarimi i plotë i të dhënave duhet të bëhet në çdo zgjedhje, një herë të vetme apo duhet ndjekur praktika e ILDKP vetëm për ndryshimet e reja vjetore.
- **Ligji 138/2015 dhe Vendimi i Kuvendit 17/2016** duhet të përfshijë edhe vende që nuk janë në BE (Zvicra, Norvegjia dhe disa vende të tjera, si dhe vendet e rajonit, përfshirë Turqinë).
- **Ligji 138/2015 dhe Kodi Zgjedhor** duhet të bëjë sqarime, p.sh. të kontradiktës, se ligji për de-kriminalizimin njih si organ verifikues vetëm KQZ, kur kandidatët lokalë sipas Kodit Zgjedhor nuk regjistrohen në KQZ, por në KZAZ. Ndërhyrja duhet të sqarojë përgjegjësinë dhe afatet.
- **Ligji 138/2015 dhe Vendimi i Kuvendit 17/2016** duhet të krijojë përputhshmëri të plotë midis kërkesave të ligjit të de-kriminalizimit dhe përmbajtjes së formularit të deklarimit, pasi aktualisht ky i fundit, ka elementë shumë më tepër sesa kërkon ligji. Në rast të procedurave ankimore kjo përbën një objekt të debatueshëm ligjor.
- **Ligji 138/2015 dhe Vendimi i Kuvendit 17/2016** si dhe **Kodi Zgjedhor** duhet të sqarojë rastet e pasaktësive në të dhëna dytësore, si p.sh. adresën e banimit rreth 20-30 vjet më parë në një vend të huaj, ose datat e sakta të lëvizjes në vite jashtë vendit, - duke specifikuar nëse detaje të tilla përbëjnë objekt penalizimi ose nëse faza e verifikimit lejon përcaktimin e saktë të tyre.
- **Ligji 138/2015 (neni 5) dhe Vendimi i Kuvendit 17/2016** duhet të sqarojnë qartësisht detyrimet dhe dispozitat për:
 - a. Njësimin 100% të formularit të deklarimit me detyrimet e ligjit organik
 - b. Konceptin “vetëm nga personi”, **pika 2, neni 5**, në rastet e pamundësisë shëndetësore ose rrethanave të tjera të pamundësisë objektive.
 - c. Koncepti “shtrembëruara” **pika 3, neni 5**, është evaziv, abuziv dhe kërkon mekanizëm verifikimi dhe specifikimi
 - d. Konceptin “mund të bëhen publike në çdo kohë dhe pa asnjë kufizim” **pika 5, neni 5**, kërkon përputhje me dispozitat ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aktet referuese ndaj KQZ dhe Prokurorisë.



- e. Koncepti “*subjekte të interesuara*” **pika 5, neni 5**, është i interpretueshëm. Duhet specifikuar por edhe zgjeruar mekanizmi i verifikimit dhe transparencës kur subjekti (p.sh, partia politike) dëshiron të mbyllë dosjen e një kandidati të saj, pra refuzon ta bëjë publike gjetjet mbi të).
- f. Koncepti “*nuk mund të kufizohet apo refuzohet në asnjë rast*” **pika 6, neni 5**, lidhet vetëm me organet shtetërore e publike, nuk ka detyrim ndaj subjekteve private dhe të huaja, si dhe duhet të ketë përputhje me legjislacionin mbi arkivat, mbi të dhënat personale dhe mbi të drejtën e informimit.
- g. Koncepti “*kohë të mjaftueshme*” **neni 6, pika 2**, duhet specifikuar sepse krijon interpretim të dukshëm.
- h. Nisma prej 500 shtetasve me të drejtë vote (**neni 7, pika 2**) e pamundëson de facto mundësinë që qytetarët ti adresohen institucioneve për verifikimin e të dhënave për politikanë apo zyrtarë me dosje kriminale. Përse 500? Një qytetar mund ti adresohet Gjykatës Kushtetuese, një qytetar mund të ketë edhe të drejtat ti adresohet organeve për zbatimin e një ligji me dobi publike.
- i. Koncepti penalizues “*kërkesa dukshëm është kryer me të dhëna të pavërteta*” dhe sqarimi i bërë në vendimin e Kuvendit, krijojnë hapësirë për interpretim dhe frenojnë de facto mundësinë që qytetarët të ndikojnë në zbatimin e këtij ligji.
- j. Koncepti “*një parti politike*” **neni 7, pika 5**, nuk është i plotë. Në zgjedhje mund të mos kemi vetëm parti politike, por mund të kemi koalicion politik apo edhe kandidatë të pavarur. Edhe këto kategori duhet të jenë të përfshira.
- k. Koncepti “*vetëm partisë*” **neni 7, pika 5** fjalja e fundit, - e mbyll procesin, nuk e bën transparent, krijon urë komunikimi midis një partie dhe prokurorisë, pa mundësi verifikimi e monitorimi të cilësisë e ndershmërisë së këtij komunikimi. Sugjerimi, të dhënat kur ka raste të gjetura të inkriminimit, duhet ti dërgohen edhe KQZ.
- l. Koncepti “*brenda apo jashtë vendit*” **neni 8, pika 5**, i lejon prokurorisë të vonojë për arsye teknike dhe administrative procesin e verifikimit, dhe e lë procesin e verifikimit në funksion të agjencive të huaja bashkëpunuese. Duhet një specifikim në afate dhe detyrimi që të dhënat në afate të bëhen publike.
- m. Koncepti i afateve ditore, (5 ditë, 10 ditë, etj) duhen specifikuar si ditë pune, ditë kalendarike, si dhe momentin e fillimit dhe mbarimit: kur merr njoftim personi, kur personi i adreson (me postë) apo depoziton direkt dokumentacionin, etj, për të mos lënë hapësirë për interpretime dhe abuzime.
- n. Koncepti “*refuzim*” **pika 6, neni 8**, duhet të marrë konsideratë rastin kur personi ndodhet në pamundësi fizike apo shëndetësore.
- o. Koncepti i raportimit të prokurorisë, **neni 8, pika 12**, duhet zgjeruar e drejta e kërkesës, jo vetëm nga deputetët, por edhe me kërkesë p.sh të Presidentit, të shoqërisë civile, të një peticioni të caktuar qytetarësh, etj.
- p. Koncepti i refuzimit, **neni 10, germa a**, - çfarë ndodh në rastin kur nuk ka afat të lirë kohor dhe kur procedura ka ndodhur midis periudhës së kandidimit dhe shtypjes së fletëve të votimit (kandidaturat shpallen në momentin e fundit ligjor). Nevojë për specifikime.
- q. Koncepti “*pavlefshmëria e mandatit – pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve*” **neni 10, germa ç**, - periudha “*pas*” kërkon afat kohor sepse është evazive dhe teorikisht zgjat 1-4 vjet.
- r. **Pika 2 dhe 3, neni 10**, që lidhet me shkarkimin e ministrit dhe votën në parlament. Ligji 138/2015 nuk ka specifikuar çfarë ndodh nëse këto procedura nuk miratohen (p.sh, brenda 48 orëve Presidenti ose kryeministri mund të mos jenë në Shqipëri dhe mundësi objektive për ushtrimin e kompetencës, votimi kundër në parlament mund të rezultojë në votë politike pro, etj).



- s. **Neni 12, pika 1**, që lidhet me kufizimet e votës për kategori të caktuar shtetasish, Kodi ose Ligji duhet të specifikojnë rastet e votimit të emigrantëve (pamundësinë e verifikimit të këtyre të dhënave).
 - t. Koncepti i pezullimit, **neni 14**, duhet të krijojë përputhje me legjislacionin tjetër në RSH, sidomos me rastet specifike, përfshirë për anëtarin e KQZ.
- Në tërësi, legjislacioni mbi de-kriminalizimin dhe nenet referuese në Kodin Zgjedhor apo në Vendimin e Kuvendit kanë nevojë për ndërhyrje në specifikime të veçanta: p.sh:
 - a. *për ndarje të qarta të kompetencave verifikuese midis KQZ, prokurorisë dhe enteve të tjera të përfshira/përgjegjëse;*
 - b. *për unifikimin e praktikave të verifikimit/deklarimit si për KQZ (mbledhje të hapura) ashtu edhe për organet e tjera;*
 - c. *për krijimin e një manuali të saktë dhe unifikues për interpretimin e saktë të veprave penale të përcaktuara nga ligji i de-kriminalizimit, në mënyrë që çdo institucion verifikues të bëjë të njëjtat interpretime për të njëjtat vepra penale*
 - d. *për sqarimin e konceptit “analiza e formularit duhet të bëhet fillimisht nga institucioni”, p.sh, KQZ. Kemi të bëjmë me analizë teknike, formale apo të detajuar/përmbajtjesore?!*
 - Nevoja për praktika unike për rastet e detyrimit ligjor mbi deklaratimet.
 - a. *kur kemi pamundësi deklarimi nominal të individit (për Presidentin dhe zyrtarë të lartë),*
 - b. *kur kemi pamundësi të tjera subjektive (gabimi ose vonesa nga shërbimi i postës, defekti në deklaratimet elektronike, dërgimi i deklaratimit në një institucion tjetër nga i duhuri, por edhe ai me kompetencë verifikimi, etj.*
 - c. *sqarimi a përbën periudha e postimit të të dhënave nga individit tek institucioni periudhë të vlefshme deklarimi, apo merret për bazë data e pranimit të materialeve?*
 - d. *sqarimi a mund të ushtrohet kjo përgjegjësi indirekt me delegim (avokat, noter, subjekt juridik, subjekt politik)?*
 - Lidhur me publikimin e formularëve të vetë-deklarimit në faqen e internetit në **pikën 3 të Kreut VI të vendimit** thuhet “Publikimi është i detyrueshëm nëse kërkohet nga një subjekt i interesuar”. Legjislacioni duhet të specifikojë cilët konsiderohen subjekte të interesuara: partitë politike, media e ndryshme, kolegët, institucioni, prokuroria, shoqëria civile monitoruese, misionet ndërkombëtare, organet e posaçme....?
 - a. *Sqarimi, a mund të ketë kufizime dhe cili institucion mund ta bëjë këtë interpretim?*
 - b. *Ligji mund të saktësonte të drejtën e institucionit kryesor (p.sh, KQZ) për një rregullorë model ku përfshihet kjo çështje.*
 - Krijimi i një database funksionale dhe arkivore me të gjitha të dhënat e deklaratimeve në kuadër të ligjit të de-kriminalizimit. Sqarimi ligjor:
 - a. *A përbën kjo një masë me mundësi abuzuese nga institucionet në të ardhmen, sidomos në rastin e fushatave elektorale?*
 - b. *A mund të ketë devijim të të dhënave në procesin e hedhjes së tyre online ose në sisteme të përpunuara, për shkak të programeve të ndryshme që përdoren?*
 - c. *A përbën zgjidhje afatgjatë përdorimi i sistemit me skaner optik për marrjen e informacioneve origjinale sipas deklaratimeve origjinale?*



Instituti i Studimeve Politike (www.isp.com.al) është një organizatë e shoqërisë civile që vepron në fushën e demokratizimit dhe shtetit të së drejtës.

ISP është e fokusuar në monitorimin e institucioneve demokratike, si dhe në hartimin e raporteve / analizave profesionale mbi problematika specifike politike me interes për qytetarët, shoqërinë dhe partnerët ndërkombëtarë.

Në kuadrin e zgjedhjeve ISP është pjesë e projektit të Dhomës Zgjedhore dhe ka krijuar një database unik, me të dhëna mbi partitë politike, zgjedhjet, dokumentet statusore e programore, me modele të funksionimit dhe problematika të aktivitetit të tyre.

Gjithashtu, ISP në fokusin e saj përfshin edhe studimin e të kaluarës komuniste në kuadrin e kujtesës kombëtare. ISP prej vitit 2014 monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit nga autoritetet publike qendrore dhe vendore duke i testuar, provuar dhe ushtruar presion pozitiv në bashkëpunim me grupet e interesit.

ISP përbëhet nga ekspertë në fushën e studimeve politike, zgjedhore, juridike, të marrëdhënieve publike, të drejtave të njeriut dhe të ekonomisë. Drejtor Ekzekutiv është Prof. Afrim Krasniqi

PROJEKTET TE REALIZUARA OSE NE VIJIM NGA ISP NE FUSHEN E ZGJEDHJEVE

- Database www.deputetim.al mbi parlamentin dhe deputetët, 2017-2020
- Database www.politike.al mbi partitë politike, zgjedhjet, organizimin e tyre, 2016-2017
- Database www.vota.al mbi votën dhe subjektet zgjedhore 1991-2017
- Monitorimi i ligjit e de-kriminalizimit (2016-2018)
- Monitorimi i reformës në drejtësi (2016-2018)
- Monitorim i zonave zgjedhore të riskut dhe stafeve elektorale, 2015 dhe 2017.
- Përfaqësimi i grave në partitë politike shqiptare 20016-2018, UN Women
- Monitorimi i përfaqësimit të grave në zgjedhjet lokale 2015, UN Women
- Monitorimi i aktivitetit parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë, Tiranë 2016.
- Komentar (broshurë) mbi ligjin “Mbi partitë politike dhe problematikat e tij”, 2016
- Monitorimin e demokracisë së brendshme në partitë politike shqiptare, 2015-2017
- Studim dhe pyetësor mbi këndvështrimet e delegatëve, Kongresi i PS, 2016.
- Monitorimin e ligjit mbi të drejtën e informimit, 2014-2015-2016
- Fushata sensibiluese “Pse voton!?”, me US Embassy, 2015.
- Database mbi organizimin e pushtetit vendor ne Shqipëri, 2015
- Projekti online www.muzeumemories.info Shqipëria në periudhën komuniste, 2014-2015

